



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202100759/2

Tiranë ___/___/2021

Lënda: *Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të të paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) "Jordan Misja" Tiranë.*

Drejtuar: **Z. Agim ISMAILI**
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Z. Edison METAJ
Drejtor i IEVP 313 "Jordan Misja" Tiranë

TIRANË

Të nderuar zotërinj,

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në neni 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe neni 81 i ligjit nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në datë 17.05.2021 në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) 313 "Jordan Misja", Tiranë.

Inspektimi u krye sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z.Besnik Deda, znj.Nertila Qafzezi, znj.Gloria Çarkaxhiu dhe z.Hazbi Selita, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Objektivi kryesor i vizitës monitoruese në IEVP 313 "Jordan Misja" ishte vlerësimi i kushteve për akomodimin dhe jetesën e të burgosurve, cilësia e trajtimit të tyre sipas të drejtave të garantuara me ligj dhe standardet ndërkombëtare, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar, ka të drejtën dhe detyrimin kushtetues e ligjor, t'ju parashtrijë gjetjet e këtij inspektimi dhe të bëjë rekomandimet përkatëse.

Shënime të përgjithshme

Kjo ishte një vizitë periodike monitoruese e Mekanizmit Kombëtar pranë Avokatit të Popullit në IEVP 313 “Jordan Misja” Tiranë për vitin 2021. Grupi i inspektimit u takua fillimisht me drejtorin e institucionit z.Edison Metaj dhe shefin e policisë z.Fatjon Sadiku, të cilët u vunë në dijeni të qëllimit të këtij inspektimi.

Gjatë takimit me drejtuesit e institucionit, grupi inspektues kërkoi fillimisht një informacion në lidhje me garantimin e të drejtave dhe trajtimin e të burgosurve në këtë institucion, kushtet për jetesë normale të krijuara në dhomat e banimit dhe ambientet e përbashkëta, si dhe verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të bëra nga institucioni i Avokatit të Popullit në inspektimet e mëparshme.

Nga drejtuesit e institucionit, na u bë me dije se në bazë të Urdhërit të Ministrit të Drejtësisë nr.381, datë 19.07.2019 "Për disa ndryshime në Urdhrin nr.8927/1, datë 27.09.2018 të Ministrit të Drejtësisë “Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, IEVP 313 “Jordan Misja” Tiranë, klasifikohet institucion paraburgimi, me një seksion të veçantë për personat që konsiderohen “bashkëpunorë të drejtësisë”, sipas kriterëve të ligjit nr.10461, datë 12.09.2011 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve të drejtësisë”, i ndryshuar dhe një seksion (godina C), për zbatimin e regjimit të posaçëm (i ashtuquajtur i 41-bis), sipas kriterëve të nenit 13/1 të ligjit nr.8328 datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar dhe në vijim neni 17 i ligjit 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

Sipas informacionit, IEVP “Jordan Misja” Tiranë duke marrë parasysh numrin e shtretërve në dhomat e banimit, në ambientet e tranzitit dhe në regjimin e posaçëm të sigurisë së lartë, ka një kapacitet fizik të miratuar për akomodimin e **468** personave. Në regjimin e brendshëm të institucionit ndodhen 3 godina me emërtimin “A”, “B” dhe “C”. Në godinën “A” me kapacitet **320** shtretër dhe në godinën “B” me kapacitet **128** shtretër, ishin të akomoduar personat e paraburgosur, ndërsa në godinën “C” me kapacitet **20-40** shtretër, ndodhej regjimi i posaçëm i sigurisë së lartë.

Në ditën e inspektimit, në mjediset e institucionit ndodheshin **416** persona, nga të cilët **406** të paraburgosur (6 prej tyre ishin të dënuar me vendim të formës së prerë) të akomoduar në godinën “A” dhe “B”, **5** persona ndodheshin në regjimin e posaçëm të sigurisë së lartë në godinën “C” dhe **5** të paraburgosur ndodheshin të shtruar në IVSHB (Spitali i Burgjeve) pranë QSUT-së Tiranë.

Situata e popullimit për periudhën e fundit 6 – mujore ishte si më poshtë vijon:

- Nëntor 2020 416 të paraburgosur/2 të dënuar
- Dhjetor 2020 382 të paraburgosur/7 të dënuar
- Janar 2021 387 të paraburgosur/4 të dënuar
- Shkurt 2021 402 të paraburgosur/4 të dënuar

- Mars 2021 401 të paraburgosur/5 të dënuar
- Prill 2021 401 të paraburgosur/6 të dënuar

Referuar statistikave të sipërpërmendura, për periudhën e ushtrimit të inspektimit konstatojmë se, në këtë institucion nuk ka patur raste të mbipopullimit. Prezenca e një numri të vogël të dënuarish me vendime të formës së prerë të akomoduar në këtë institucion, sipas informacionit të drejtuesve të institucionit, kishte të bënte me dinamikën e shqyrtimit të çështjeve në gjykatë, si dhe me kohën në dispozicion të DPB-së për transferimin e tyre në IEVP-të e tjera, për shkak të problematikave që ata mbartin.

Sa i takon funksionimit të shërbimeve, ato ishin të organizuara në regjimin e brendshëm të institucionit. Në katin e parë të godinës “A” ndodheshin ambientet e sektorit të tranzitit, observimit dhe veçimit. Gjithashtu, në godinën “A” dhe godinën “B”, kishte nga një Seksion të Kujdesit të Veçantë (SKV), ku trajtoheshin kryesisht të sëmurë me probleme të shëndetit mendor. Ndërsa ambienti i kuzhinës dhe lavaneria ndodheshin në katin e parë të godinës “A”.

Organika e IEVP 313 “Jordan Misja”, Tiranë, përbëhej nga një numër prej 213 punonjësish, nga të cilët 36 punonjës të sektorit civil dhe 175 punonjës të sektorit të policisë. Aktualisht, stafi kishte 207 punonjës, nga të cilët 31 punonjës civil dhe 174 punonjës të policisë. Mungesat në organikë konsistonin përkatësisht: 1 përgjegjës i sektorit të logjistikës, 1 specialist në sektorin e shërbimit ligjor, 1 farmacist, 1 ndihmësmjek, 1 motorist/elektrici dhe 1 punonjës i shërbimit policor. Pavarësisht këtyre mungesave të stafit, grupi i inspektimit konstatoi se ato nuk ndikonin në ofrimin e shërbimeve bazë ndaj të burgosurve.

Gjithashtu, grupit të inspektimit ju vu në dispozicion struktura dhe organika e re e IEVP-së “Jordan Misja”, Tiranë, miratuar me Urdhër Nr.43 datë 25.03.2021 të Kryeministrit të RSH “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithëshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve të varësisë së saj*”. Ajo përbëhej nga 317 punonjës, prej të cilëve 32 punonjës civil dhe 285 punonjës të sektorit të policisë. Ndryshimet në strukturën dhe organikën aktuale, konsistonin jo vetëm në rritjen e numrit të punonjësve, por dhe në faktin se struktura e re organike parashikon një rritje të stafit në sektorin e çështjeve shoqërore me punonjës social. Gjithashtu, stafi shëndetësor që do shërbejë në institucionet e varësisë të DPB, tashmë do jenë në varësi organike të Institucionit të Veçantë Shëndetësor të Burgjeve (IVSHB). Sipas informacionit, kalimi nga struktura organike aktuale në strukturën e re organike, duhet të përfundojë brenda një periudhe 3-mujore nga miratimi i saj, deri në muajin shtator 2021.

Sipas informacionit të drejtuesve dhe stafit të institucionit, nga inspektimi i kryer në ambientet e regjimit të brendshëm, si dhe intervistat konfidenciale të zhvilluara me personat e burgosur rezultoi se:

1. **Ishte plotësuar rekomandimi**, për të shmangur bashkëjetesën e të paraburgosurve me të dënuarit në këtë institucion, duke bërë të mundur transferimin e shpejtë të

personave që ishin dënuar me vendim të formës së prerë drejt institucioneve të tjera të vuajtjes së dënimit.

2. **Ishte realizuar rekomandimi**, për vënien në zbatim të skemës së furnizimit dhe rimbursimit të ilaçeve në IEVP “Jordan Misja”, Tiranë sipas kontratës tre palëshe me FSDKSH dhe depon farmaceutike.
3. **Ishte plotësuar rekomandimi**, për pajisjen e institucionit me ambulancë të re për shoqërimin e personave me probleme shëndetësore për vizita mjeksore pranë QSUT-së Tiranë, në përputhje me nevojat shëndetësore të të paraburgosurve.
4. **Ishte plotësuar rekomandimi**, për furnizimin me detergjentë dhe materiale pastrimi, sipas normativave që i takon çdo të paraburgosuri, si dhe për nevoja të parandalimit të COVID-19 në këtë institucion.
5. **Ishte plotësuar rekomandimi**, për programimin e aktiviteteve dhe takimeve me të paraburgosurit dhe në veçanti për 18-21 vjeçarët gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, për qëllime rehabilitimi, këshillimi dhe ri-integrimi, individuale dhe punë në grup .

Ndërkohë, në krahasim nga inspektimi i mëparshëm, disa nga rekomandimet e MKPT-së nuk kishin gjetur zbatim dhe nuk ishin plotësuar dhe konkretisht:

1. **Nuk ishte realizuar rekomandimi**, lidhur me investimin për rikonstuksionin e Godinës “A” të banimit të të paraburgosurve në këtë institucion, për të siguruar ambiente të përshtatëshme dhe dinjitoze për jetesë normale, si dhe ambiente për kryerjen e aktiviteteve edukative dhe sportive.
2. **Nuk ishte realizuar rekomandimi**, për riparimin e rrjetit elektrik dhe sigurimin e një sistemi qëndror për ngrohje/ftohje të dhomave të të paraburgosurve në godinën “A” të institucionit, sipas kushteve klimaterike.
3. **Nuk ishte realizuar rekomandimi**, për ndryshimin e urdhërit të përbashkët të Ministrisë të Drejtësisë dhe Ministrisë të Shëndetësisë, për përmirësimin e kuotave dhe larmishmërisë të ushqimit, për të burgosurit në institucionet e sistemit penitenciar.
4. **Nuk ishte realizuar rekomandimi**, për ndryshime dhe përmirësime në rregulloren e brendshme të seksionit të posaçëm të regjimit të sigurisë së lartë (*i ashtuquajtur 41-bis*), sipas parashikimeve në ligjin nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, si dhe rekomandimit të Avokatit të Popullit¹, me qëllim që masat shtrënguese të jenë në një ekuilibër midis sigurisë dhe garantimit të dinjitetit dhe shëndetit të të paraburgosurve që vuajnë dënimin në këtë regjim.

Në lidhje me situatën anti COVID-19, institucioni kishte në kontroll monitorimin e situatës, duke zbatuar masat e parashikuara në protokollin shëndetësor të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për parandalimin e kësaj sëmundje infektive. Për periudhën e inspektimit, nuk kishte asnjë të paraburgosur apo staf i këtij

¹ Rekomandim i Avokatit të Popullit nr.K4/A4-5 prot., datë 23.09.2020 drejtuar Ministrisë të Drejtësisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve. <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Varianti%20final%20regjimi%2041%20biss%20mkpt.pdf>

institucioni që të ishin të infektuar nga kjo sëmundje. Në hyrje të institucionit ishte vendosur ura dizifektuese për stafin dhe vizitorët që hynin në institucion, ndërkohë që punonjësi i informacionit kryente më tej me termometër digital matjen e temperaturës. Këto veprime regjistroheshin në një regjistër të veçantë, që mbahej nga punonjësi i informacionit. Ndërsa në ambinetet e punës të stafit dhe në ambientet e koridoreve të sektorëve në regjimin e brendshëm, ishin të vendosur dezifektantë për pastrimin e duarve. Të paraburgosurit që paraqiteshin në seanca gjyqësore pajiseshin me maska mbrojtëse nga institucioni, ndërsa ata që shkonin për vizita mjeksore në QSUT Tiranë apo Spitalin e Burgjeve, pas kthimit në institucion, karantinoheshin për 14 ditë në ambientin e observimit, në bazë të urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve. Një nga masat e rëndësishme për parandalimin e sëmundjes infektive, është mbajtja pastër dhe higjienizimi i ambienteve individuale dhe kolektive, por në godinën “A” gjendja e kushteve dhe pastërtisë kryesisht në ambientet e observimit, veçimit dhe të tranzitit që ndodheshin në katin e parë të kësaj godine, ishin në gjendje të keqe dhe linin për të dëshiruar sa i takon respektimit të standardeve.

Nga ana e drejtuesve të institucionit, ekspertëve të grupit inspektues iu ofrua mundësia që të kishin akses në përputhje me rregulloren dhe pa vështirësi me të gjithë personat dhe në të gjithë ambientet e regjimit të brendshëm që duhet të monitoronin. Vizita në këtë institucion u zhvillua në një frymë të mirë bashkëpunimi.

Trajtimi

Grupi i inspektimit pati për objektiv të punës së tij mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve, për identifikimin e rasteve të përdorimit të forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative apo të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, si edhe të rasteve të marrjes së masave disiplinore.

Nga informacioni i marrë nga drejtuesit dhe kryesisht nga stafi i sigurisë të institucionit, si dhe nga intervistat e zhvilluara në grup dhe atyre konfidenciale me të paraburgosurit, grupi i inspektimit nuk evidentoi raste me pretendime për ushtrim të dhunës apo tejkallim të forcës fizike nga ana e punonjësve të policisë së burgjeve.

Megjithatë, nga intervistat konfidenciale të zhvilluara me të paraburgosurit, rezultoi se kishte disa ankesa që ishin të lidhura kryesisht me kushtet e përgjithshme të jetesës në institucion. Ankesa më të shumta vinin nga të paraburgosurit që ishin të akomoduar në godinën “A”, e cila është një godinë e vjetër dhe e amortizuar. Ato konsistonin në kushtet e papërshtatshme për jetesë në dhomat e banimit, të cilat janë të vogla dhe nuk plotësojnë kriteret e sipërfaqes dhe të hapsirës që duhet të sigurohet për çdo person; prezencën e lagështirës në disa dhoma banimi dhe kryesisht në ambinetet e përbashkëta të tualeteve dhe dusheve; problemet me sistemin elektrik dhe mungesën e sistemit qëndror për ngrohje/ftohje, për t’iu përshtatur kushteve klimaterike; mungesën e ujit të ngrohtë për larjen e trupit; kushtet e papërshtatshme në ambientet e përbashkëta të vuajtjes së dënimit dhe veçanërisht në ambientet e ajrimit, të cilat janë shumë të kufizuara në godinën “A”, etj.

Një grup ankesash, kishin të bënin me mungesën e takimeve fizike me familjarët për shkak të kohëzgjatjes prej më shumë se një viti, për shkak të masave parandaluese për përhapjen e sëmundjes infektive COVID-19, si dhe mungesën e aktiviteteve rekreative kulturore dhe sportive me grupe të burgosurish, për shkak të mungesës të ambienteve dhe infrastrukturës që ka ky institucion².

Ankesa u paraqitën dhe për mungesën e larmishmërisë dhe cilësinë e ushqimit, duke bërë që ushqimi që gatuhet nga kuzhina e institucionit të mos konsumohej prej tyre.

Gjithashtu, mungesa e njësisë tregtare kishte krijuar një shqetësim për një pjesë të të paraburgosurve, kryesisht ata që kanë larg familjet e tyre dhe personat e huaj që vujanë dënimin në këtë institucion, të cilëve nuk mund t'ju dërgojnë rregullisht ushqime dhe materiale për nevoja personale.

Grupi i të paraburgosurve që ndodheshin në dhomat e observimit, veçimit dhe të tranzitit, të cilët u intervistuan gjatë kohës së inspektimit, ngritën si shqetësim kushtet e papërshtatshme të jetësës në këto ambiente, të cilat ishin tejet të vështira, me kushte degraduese dhe jo dinjitoze. Kjo situatë u evidentua si e tillë edhe nga grupi i inspektimit dhe përbën një problem serioz, pasi numri më i madh i të burgosurve janë të akomoduar pikërisht në godinën “A”, ku ndodhen dhe ambientet e observimit, tranzitit dhe veçimit. Në këtë kuadër, duhet të vlerësohet nga DPB edhe shkurtimi sa më shumë i kohës të qëndrimit të personave që akomodohen në dhomat e tranzitit të burgosurve që vijnë nga IEVP-të e tjera, për shkak të detyrimit që kanë të burgosurit për tu paraqitur në seancat gjyqësore që zhvillohen në gjykatat në Tiranë.

Lidhur me gjendjen e godinave dhe kushtet e jetësës në dhomat e banimit, godina “B” dhe “C” kishin ndryshime pozitive në raport me godinën “A”. Gjendja e kushteve të akomodimit, pastërtia dhe higjenizimi i ambienteve, ishin të një cilësie të mirë. Grupi i inspektimit, konstatoi rregullsi dhe pastërti në dhomat e banimit, në ambientet e dusheve dhe ambientet e përbashkëta.

Masat mbrojtëse

Në përputhje me standardet e përgjithshme që garantojnë repektimin e të drejtave të personave në IEVP, grupi i inspektimit u njoh dhe administroi kopje të dokumentacionit ku ishin të evidentuara praktikatat e punës sipas sektorëve, me qëllim vlerësimin e kushteve dhe trajtimin e personave të dënuar dhe të paraburgosur.

² Kjo çështje u adresua në urdhërin e ri të Ministrisë të Drejtësisë, për heqjen e disa kufizimeve, për shkak të pandemisë.

Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacionit lidhur me sistemin e kërkesë/ankesave rezultoi se kërkesat dhe ankesat e të paraburgosurve ishin të regjistruara në regjistrin përkatës dhe ishin të protokolluara³. Regjistrat mbaheshin nga sekretaria e institucionit.

Të paraburgosurit/dënuarit plotësonin një formular kërkesë/ankese dhe ia dorëzonin më pas punonjësit të sektorit psiko-social. Punonjësi i dërgonte në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim apo i takonte vetë të dënuarit ose punonjësit e institucionit zhvillonin takimet sipas rasteve brenda afatit 3(tre) ditor. Brenda në regjim kishte kuti postare ku mund të hidheshin ankesat/kërkesat. Gjatë vitit 2021 ishin evidentuar në regjistër gjithsej 37 kërkesë/ankesa nga të paraburgosurit.

Sipas shënimeve në regjistër, objektit i kërkesave kishte të bënte me kërkesa për takime me familjarë, kërkesë për takim me avokatë, vizita në spital, punësim ose kërkesë për blerjen e pajisjeve si TV ose frigorifer.

Grupi i monitorimit, mori informacion në lidhje me procedurat që ndiqen për pritjen e të paraburgosurve në institucion, funksionimin e Komisionit të Pritjes, si dhe plotësimin e regjistrave e dosjeve personale psiko-sociale të tyre.

Nga intervistat me punonjësit e institucionit dhe verifikimet në dosjet përkatëse, grupi monitorues konstatoi se procedura e pranimit në institucion zbatohet sipas rregullores të brendshme. Nga inspektimi dhe verifikimi i dokumentacionit rezultoi se veprimet që kryheshin me hyrjet e reja në institucion, regjistroheshin në regjistrin përkatës dhe protokolloheshin.

Sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi ishte funksional. Institucioni ishte i pajisur tërësisht me kamera vëzhgimi. Në IEVP “Jordan Misja” Tiranë kamerat monitoronin të gjitha mjediset për 24 orë, ndërkohë që të dhënat ruheshin në server për një periudhë 30 ditore.

Aparatet e telefonave me kartë, ishin të instaluar në korridoret e secilit prej sektorëve në regjimin e brendshëm dhe në ambientet e ajrimit. Ata ishin në gjendje pune dhe të paraburgosurit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin me familjarët e tyre rregullisht 2 herë në javë. Nga verifikimi i numrave të telefonit të Institucionit të Avokatit të Popullit, grupi i inspektimit konstatoi se, ata punonin rregullisht dhe biseda ishte pa pagesë.

Ndërkohë, takimet me familjarë vazhdonin të kryheshin online, sipas protokollit anti COVID-19. Në ambientin e takimeve të secilës prej godinave, ishin instaluar nga 2 kompjutera që shërbenin për lidhje me skype. Takimet online zhvilloheshin rregullisht 4 takime në muaj, ndërkohë që të paraburgosurit ngrinin ankesa ndaj drejtuesve të institucionit, se duhet të gjenden mënyra alternative për zhvillimin e takimeve fizike, pasi

³ Neni 58 i ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

kaloi një periudhë e gjatë pa takuar fëmijët dhe familjarët e tyre. Nga intervistat me drejtuesit e institucionit dhe të burgosurit, si dhe monitorimi në vend që zhvilloi grupi i inspektimit, u konstatua se nuk kishte vërejtje për takimet online dhe kohëzgjatjen e tyre.

Ambientet e takimeve ndodheshin në katin e parë të secilës prej godinave, ato ishin të pajisur me tavolinë dhe karrige, ku të paraburgosurit qëndronin ulur duke patur kontakt fizik me familjarët e tyre, por që nuk janë përdorur gjatë periudhës së pandemisë.

Organika e IEVP “Jordan Misja” Tiranë parashikonte të kishte 46 të punësuar nga të paraburgosurit, por aktualisht ishin punësuar vetëm 16 të paraburgosur, të cilët punonin kryesisht si pastrues, sanitarë, shpërndarës ushqimi etj. Nga intervistat që grupi inspektues zhvilloi me disa nga të punësuarit, nuk kishin pretendime për kushtet e punës.

Të dënuarit që ishin të punësuar përfitonin nga ulja e dënimit me 3.9 ditë në muaj. Kjo procedurë ndiqej për arsye se, ende nuk janë miratuar aktet nënligjore të nevojshme që garantojnë të drejtën për punësim dhe shpërblim të drejtë të punës për të burgosurit, sipas parashikimeve në aktet ligjore në fuqi. Ndërsa, të paraburgosurve nuk ju garantohet asnjë shpërblim për ditët e punës apo lehtësim tjetër ligjor, pasi ata i përfitojnë automatikisht këto të drejta, vetëm nëse dënohen me vendim të formës së prerë. Nëse gjykata kompetente, vendos lënien të lirë të të paraburgosurve, ata nuk kanë asnjë përfitim shtesë nga punësimi në IEVP, madje kjo periudhë e punësimit, nuk ndikon as në llogaritjen e kohëzgjatjes së paraburgimit për këta persona.

Punësimi i të burgosurve dhe shpërblimi për punën e kryer, rregullohet sipas neneve 43 dhe 44 të ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”. Në nenin 43 të ligjit të sipërcituar ndërmjet të tjerave parashikohet se, “Rregullat e posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës dhe kohëzgjatja e saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”, ndërsa në nenin 44 të këtij ligji parashikohet dhe e drejta e një shpërblimi mujor për punën e kryer, ku thuhet shprehimisht se, “Shpërblimi për secilën kategori caktohet në vlerë të drejtë në proporcion me sasinë dhe cilësinë e punës së kryer dhe organizimin e punës që rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Pavarësisht se, në nenin 91 të ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, parashikohet miratimi nga Këshilli i Ministrave i akteve nënligjore në zbatim të tij **brenda gjashtë muajve** nga hyrja në fuqi e këtij ligji, konstatohet se deri më tani **nuk** është miratuar asnjë prej VKM-ve lidhur me kriteret e punësimit dhe për shpërblimin e punës së të burgosurve.

Avokati i Popullit, referuar parashikimeve në ligjin e mëparshëm nr.8328 datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, ka rekomanduar në mënyrë të përsëritur miratimin brenda afateve ligjore të akteve nënligjore që lidhen me punësimin dhe kriteret e shpërblimit të punës, por ato akte nuk u miratuan deri në shfuqizimin e këtij ligji dhe miratimin e ligjit të ri.

Aktualisht, ndonëse ka kaluar një vit që ligji nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” është miratuar, aktet nënligjore për punësimin që rregullohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, edhe pse tej çdo afati ligjor⁴, ende nuk janë miratuar.

Grupi i inspektimit të MKPT-së, i kushtoi një vëmendje të veçantë kushteve dhe trajtimin e personave të paraburgosur që ndodheshin në regjimin e posaçëm të sigurisë së lartë të këtij institucioni, sipas kërkesave të nenit 17 të ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

Regjimi i posaçëm ndodhej në godinën “C” të I EVP-së “Jordan Misja”, ku ishin akomoduar 5 persona të paraburgosur, sipas urdhërave të Ministrit të Drejtësisë. Në katin zero ndodheshin ambientet e shërbimeve si mjedisi i takimit me familjarët (pesë poste takimi të ndara me xham dhe komunikimi kryhej përmes citofonisë), një dhomë e takimit me avokatin/prokurorin/opgj, një dhomë këshillimi, si dhe mjedisi i tualeteve dhe dusheve i ndarë në tre bokse.

Në katër katet e tjera, një ndër të cilët është ndërtuar nëntokë, ndodheshin dhomat e të paraburgosurve dhe dushet e përbashkëta. Në ndryshim nga inspektimi i vitit të kaluar, në katin që ndodhej nëntokë, nuk kishte asnjë të paraburgosur. Aktualisht ata ishin të akomoduar në katin e dytë dhe të tretë të kësaj godine. Në çdo kat kishte nga 5(pesë) dhoma. Dhomat kishin nga dy shtretër të fiksuar në dysheme, një tavolinë të vogël të fiksuar në dysheme në një nga këndet e dhomës, një kalorifer për ngrohje, një tualet me një lavaman dhe një pasqyrë alumini të fiksuar në mur me vida. Dritarja ishte e mbyllur me dy kanate me xham dhe e siguruar me zgarë hekuri dhe me grrilë hekuri të fiksuar në mur.

Nga intervistat me personat që ishin vendosur në këtë regjim, u evidentua se dhomat nuk kishin ajrim dhe ndriçim të mjaftueshëm natyral, për shkak se grrilat e hekurit kishin hapsirë shumë të vogël mes tyre dhe nuk lejonin depërtimin e ajrit dhe dritës natyrale. Ndërkohë, dhomat, koridoret në secilin kat, si dhe ambientet e përbashkëta, kishin ndriçim artificial që furnizoheshin nga rrjeti elektrik. Ato komandoheshin nga punonjësit e sigurisë që shërbenin në këtë regjim.

Ajrimi i të paraburgosurve ishte i vetmi aktivitet që zhvillohej rregullisht me të paraburgosurit në këtë regjim. Ambienti i ajrimit ndodhej në sheshin përpara godinës “C” dhe përbëhej nga 4 bokse ajrimi të cilat ishin me gjatësi dhe gjerësi të mjaftueshme për të kryer lëvizje, ndërsa në pjesën e sipërme ishin të mbuluar me një rrjetë, për arsye sigurie. Orari i ajrimit ishte përcaktuar në rregulloren e regjimit të posaçëm dhe kryhej rreth 2 orë në ditë.

⁴ Neni 91, pika 2 e ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

Dushet e përbashkëta kishin nga 6 (gjashtë) bokse për larjen e trupit. Kokat e dusheve ndodheshin në lartësinë jo më shumë se dy metra nga dyshemeja, të fiksuara në murin ndarës të bokseve. Në koridor ishin vendosur dy telefona me kartë të dy kompanive të ndryshme, për të komunikuar me familjarët e tyre, sipas procedurave të miratuara për këtë qëllim. Ndërsa, komunikimi me Institucionin e Avokatit të Popullit, bëhej nëpërmjet këtyre telefonave pa pagesë dhe numrave të telefonit të afishuar në korridoret e çdo sektori.

Sa më sipër, neni 8/2 i Rregullores së Regjimit të Posaçëm parashikon se, ndriçimi, drita artificiale, ngrohja do të jenë sipas kërkesave të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve. Ndërkohë që, neni 30/1 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve përcakton se: *“Dritarja duhet të mundësojë **ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal** për të lexuar e punuar. Kokat e dusheve të fiksuara në lartësinë jo më shumë se dy metra nga dyshemeja i krijojnë lehtësi të paraburgosurit për të kryer vetvrasje”*.

Qëllimi i regjimit të posaçëm është për të parandaluar kontakte me organizatën kriminale ku i burgosuri bën pjesë, konfliktet me element të organizatave kundërshtarë, ndërveprimin me të burgosurit e tjerë që i përkasin të njëjtës organizatë ose organizatave të tjerë bashkëpunuese, komunikimin apo shkëmbimin e sendeve ndërmjet të burgosurve që i përkasin grupimeve të ndryshme.

Në këtë kuadër, referuar standardeve ndërkombëtare që garantojnë të drejtat dhe dinjitetin njerëzor të këtyre personave, si dhe eksperiencat e vendeve të tjera ku është aplikuar ky regjim, nuk parashikohet që këta të burgosur të privohen nga aktivitetet sportive, kulturore, krijuese, leximi i librave të shumëllojshëm, veprimtari që i shërbejnë rehabilitimit dhe ri-integritit të këtyre të burgosurve. Përkundrazi, aktivitetet me karakter edukues qofshin këto edhe individuale, në këtë regjim janë edhe më të domosdoshme se në çdo regjim tjetër, me qëllim për të zbutur rreptësinë e kufizimeve të parashikuara në ligj.

Avokatit i Popullit si institucion kushtetues i pavarur, nisur nga analiza e bërë kushteve të përcaktuara në legjislacionin kombëtar për ngritjen dhe funksionimin e regjimit të posaçëm të sigurisë së lartë, akteve administrative të miratuara nga organet kompetente në Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, si dhe logjistika e duhur për ta bërë të zbatueshëm regjimin e posaçëm, **ka rekomanduar**⁵ marrjen e një sërë masash për lehtësimin e kufizimeve, duke ruajtur një ekuilibër midis sigurisë dhe dinjitetit të të burgosurve. Kjo praktikë është vlerësuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit, me përputhshmërinë e masave kufizuese të parashikuara në Kushtetutën e RSH, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga RSH, si dhe vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut apo dhe me ligjin Italian për të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve.

⁵ Rekomandim nr.K4/A4-5 prot., datë 23.09.2020 drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe DPB.

Nga intervistat e zhvilluara me të paraburgosurit në regjimin e posaçëm, rezultoi se asnjë nga masat kufizuese të parashikuara në rregulloren e brendshme, **nuk** kishte ndryshuar që prej kohës së aplikimit në bazë të urdhërit të Ministrit të Drejtësisë, përveç ndryshimit të kateve të qëndrimit.

Kushtet materiale

Grupi i monitorimit, në fokus të vizitës së tij kishte dhe monitorimin e kushteve materiale, si elemente shumë të rëndësishme në respektimin e standardeve për jetesë normale. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale “Jordan Misja” Tiranë, ka filluar funksionimin vetëm me godinën “A”, e cila është e trashëguar prej vitesh dhe pavarësisht disa rikonstruksioneve ajo është shumë e amortizuar. Gjithashtu, vitet e fundit në regjimin e brendshëm janë shtuar edhe 2(dy) godina të reja (godina “B” dhe “C”), të cilat disponojnë kushte dhe infrastrukturë më të mirë për jetesë. Infrastruktura e përgjithshme e institucionit me marrjen në dorëzim të godinave të reja, ishte e mirë me ndarje të rregullta të godinave dhe ofronte funksionalitet në lëvizje dhe në elementët e sigurisë.

Në institucion baza materiale për jetesë ishte e plotësuar. Ishte siguruar kompletimi me shtretër dhe nuk kishte asnjë person që flinte në tokë. Nga inspektimi i dhomave të banimit, u konstatua se baza materiale përgjithësisht ishte e plotësuar, por kishte të paraburgosur që deklaronin se bataniet dhe çarçafët, i siguronin nga familjarët e tyre.

Kubatura dhe sipërfaqet e dhomave të banimit ishin të vogla, në raport me numrin e personave të akomoduar në secilën prej tyre. Në dhoma ishin akomoduar nga 2-4 persona. Dhomat ishin të pajisura me orënditë e nevojshme si tavolinë, karrige dhe komodina, por ishin të pamjaftueshme për mbajtjen e sendeve personale dhe ushqimeve të të paraburgosurve, dhe një pjesë e materialeve ruheshin në qeska të vendosura në dysheme. Niveli i ajrit dhe dritës natyrale në dhoma ishin të mjaftueshme, ndërkohë që të gjitha ambientet në regjimin e brendshëm, kishin edhe ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik.

Nga vlerësimi i kushteve materiale të institucionit, ato nuk janë sipas parametrave teknik dhe jetësor të përcaktuar në legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar. Vlen të theksojmë se Komiteti për Parandalimin e Torturës shprehet se norma minimum e hapësirës për person, në institucione të tilla, është 6m² për dhomat për një person dhe 4m² kur në to sistemohen më shumë persona. Në këtë normë nuk mbahet parasysh sipërfaqja e tualetit, që mund të ndodhet brenda dhomës. Gjithashtu, sipas standardit të Komitetit për Parandalimin e Torturës, duhet respektuar dhe distanca ndërmjet mureve të dhomave, që duhet të jetë jo më pak se 2m distancë ndërmjet mureve të dhomës dhe jo më pak se 2.5m distancë nga dyshemeja me tavanin e dhomës.⁶

⁶ Vendimi Nr.437, datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, Neni 30 parashikon se: “Në vendosjen e të paraburgosurve apo të të dënuarve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo IEVP-je, por në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4m² për çdo person të paraburgosur apo të dënuar, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar”.

Pavarësisht faktit që në këtë institucion nuk kishte mbipopullim, grupi i inspektimit evidentoi se ishin shkelur parametrat teknik dhe jetësor që duhet të garantojnë dhomat e banimit për të burgosurit. Konkretisht, në dhomat e godinës “B” (godinë e re) standardi për normën e lejuar të hapsirës dhe sipërfaqes për person respektohej, ndërsa në godinën “A” (godina e vjetër) këto parametra ishin të kushtëzuar dhomat e vogla dhe numri i personave të paraburgosur që gjendeshin në secilën dhomë, gjë e cila **nuk** garantonte respektimin e hapësirës dhe të hapsirës jetike për çdo të burgosur.

Në këtë kuadër, është e nevojshme të bëhet rishikim i akteve të brendshme që përcaktojnë kapacitetin fizik të I EVP 313, nisur nga kushtet në të cilën ndodhen të burgosurit në godinën “A”, me qëllim që personave që do akomodohen në dhomat e kësaj godine, tu garantohet e drejta për normat minimale të hapsirës dhe sipërfaqes për çdo të burgosur.

Ngrohja e ambienteve të brendshme kryhej me kaldajë qëndrore, por për shkak të kushteve klimaterike kishte problematikë lidhur me oraret që aplikoheshin. Në këto kushte, nga ana e institucionit ishin marrë disa masa për të lejuar futjen e ngrohësave dhe ftohësve të lëvizshëm brenda dhomave sipas stinëve. Vendosja e këtyre pajisjeve, krijonte ngarkesë në rrjet dhe defekte elektrike, kryesisht në godinën “A” ku sistemi elektrik ishte i amortizuar.

Dushet ishin të mirëmbajtura dhe në përgjithësi me kushte të mira higjieno sanitare, sidomos në dy godinat e reja. Nga intervistat e zhvilluara në të gjithë sektorët e të tre godinave të banimit u pohua se dushi realizohej përgjithësisht 2 (dy) herë në javë. Në lidhje me larjen e trupit, të paraburgosurit paraqisnin disa ankesa se uji i ngrohtë nuk ishte i mjaftueshëm dhe nuk përballonte fluksin e numrit për çdo sektor.

Cilësia e ujit ishte e mirë dhe furnizimi me ujë nuk kishte probleme. Në këtë institucion ishin vendosur edhe 4 (katër) depozita me ujë me kapacitet 5 000 litra secila, me një total prej 20 000 litrash. Ngrohja e ujit realizohej me bolier dhe me panele diellore. Në ambientet e përbashkëta, kishte bazë materiale të shpërndarë sipas nevojave.

Takimet me familjarët në këtë institucion vijonin të zhvilloheshin online, rregullisht 4 herë në muaj. Në ambientet e takimeve, ishin instaluar nga 2 kompjutera për lidhje me skype në godinën “A” dhe në godinën “B”. Ambienti i takimit ishte i vendosur në katin e parë të dy godinave (A-B) të institucionit dhe ishte i ndarë nga ambientet e tjerë. Ndërsa, të paraburgosurit që ndodheshin në regjimin e posaçëm, kishte ambient më vete për takimet online me familjarët e tyre.

Spektori i observimit, veçimit dhe ai i tranzitit ishin ambiente më vehte dhe ndodheshin në katin e parë të godinës “A” të këtij institucioni. Nga pikpamja e organizimit dhe procedurave që ndiqeshin, ato funksiononin normalisht sipas parashikimeve në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Në sektorin e obeservimit ditën e inspektimit

gjendeshin 14 persona, në sektorin e tranzitit 9 persona dhe në veçim (me masa disiplinore) 2 persona të paraburgosur.

Shqetësuese në këta sektorë, ishte mungesa e kushteve materiale dhe e higjenzimit të këtyre ambienteve. Në të tre këto ambiente, akomodohen persona të paraburgosur që qëndrojnë nga 1-15 ditë, sipas afateve të parashikuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Grupi i inspektimit konstatoi se, në dhomat e këtyre sektorëve ishte prezent niveli i lartë i lagështirës tej normave të lejuara, si dhe kishte mungesa në dyshekë, batanie dhe jastek. Nga intervistat që u zhvilluan me personat që ndodheshin në dhomat e tranzitit, deklarorin se ata vinin nga IEVP-të e tjera dhe për shkak të datave të zhvillimit të seancave gjyqësore, qëndronin në këto dhoma edhe deri 4 ditë. Në këto kushte, institucioni **nuk** i furnizonte rregullisht me materiale për fjetje, duke i detyruar ata të flinin në dyshekë dhe batanie të vjetëruara që mbanin njëkohësisht edhe erë të rëndë myku. Dhomat kishin tualetet brenda hapsirës së tyre, por mungonin pajisjet hidrosanitare dhe **nuk** kishin dyer. E njëjta situatë paraqitej edhe në sektorët e observimit dhe të veçimit. Grupi i inspektimit, konstatoi gjithashtu se edhe kushtet higjeno-sanitare të dhomave dhe tualeteve **nuk** ishin aspak të mira dhe nuk ishin të lyera.

Një problematikë me specifikë të veçantë, që u ngrit nga të paraburgosurit që ndodheshin në ambientin e tranzitit, kishte të bënte me mungesën e pjatave dhe lugëve, për konsumin e ushqimit ditor. Institucioni pretendonte se, duke qenë se të paraburgosurit qëndronin vetëm disa ditë në këto ambiente, ata i thyenin dhe keqpërdornin ato. Në këto kushte, ngrënia e ushqimit shërbehej në pjata plastike, të cilat nuk ishin të mjaftueshme për të tre vaktet (jepej një pjatë në ditë për çdo person) dhe ato **nuk** ishin të pastra nga ana higjenike. Veç kësaj, sikurse theksuam dhe më lart, në dhomat e tranzitit, observimit dhe të veçimit kishte mungesa të theksuara të kushteve higjenes dhe pastërtisë, ndaj konsumimi i ushqimit në këto kushte ishte jashtë çdo standardi minimal, për jetën dhe shëndetin e këtyre personave.

Në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, gjendja në të cilën ndodheshin kushtet në sektorin e observimit, veçimit dhe të tranzitit përbënin një trajtim jo dinjitoz të personave që ndodheshin në këto ambiente, që dëmton rëndë shëndetin e tyre. Dhomat kishin nevojë të menjëhershme për rinovimin e materialeve të fjetjes, lysterjen e dhomave dhe dizifektimin 3D, pasi personat që ndodheshin në këtë ambient ankoheshin se kishte brejtës të ndryshëm me pasoja për shëndetin e tyre.

Në IEVP “Jordan Misja” kishte palestër, klasa dhe dhoma këshillimi sipas sektorëve. Palestra ishte pajisur me mjete të pajisura nga institucioni, si dhe vegla për ushtrimin e forcës të sjella nga vetë të paraburgosurit. Ushtrimi në palestër dhe orari i ajrimit, ishin aktivitetet kryesore që zhvillonin të paraburgosurit, pasi aktivitetet kulturore dhe sportive masive nuk zhvilloheshin për shkak të masave anti COVID-19 në fuqi, por edhe për shkak të mungesës së infrastrukturës në institucion. Gjatë periudhës së pandemisë edhe palestrat në shumicën e kohës kanë qenë të mbyllura, për shkak të masave kufizuese.

Ambientet e kultit ishin të bollshëme, me ndriçim dhe të pajisur me orenditë e nevojshme. Kryerja e riteve fetare, nuk ishte lejuar, kjo për shkak të grumbullimeve, të cilat nuk janë lejuar gjatë periudhës së pandemisë.

Institucioni kishte në total 12 (dymbëdhjetë) ambiente ajrimi, nga të cilat 4 (katër) bokse ndodheshin në katin e tretë të godinës ‘A’ dhe 8 (tetë) bokse ndodheshin në sheshin mes godinave. Këto ambiente ishin të pastra dhe të mirëmbajtura. Në këto ambiente ndodheshin gjithashtu edhe telefona ku të paraburgosurit/dënuarit i shfrytëzonin për të kontaktuar me familjarët. Telefonat ishin funksionalë në të gjitha ambientet e ajrimit.

Kuzhina e institucionit ishte funksionale, me hapsirë dhe sipërfaqe të mjaftueshme, si dhe me higjienë të mirë. Muret e kuzhinës ishin të lyera. Brenda hapsirës të kuzhinës ndodhej edhe magazina për ushqimet. Kuzhina ishte në kushte normale, pasi pajisjet e gatimit dhe sistemi i aspirimit ishin të standardeve industriale. Në kuzhinë ndodhej regjistri i normativave ushqimore dhe menuja ditore e afishuar. Regjistrat e kontrollit të ushqimit dhe të menisë së gatimit ishin të sekretuar dhe të protokolluar. Stafi i kuzhinës ishte i kompletuar sipas organikës dhe ishin të pajisur me librezën e shëndetit. Në momentin e inspektimit, po përgatitej shpërndarja e vaktit të drekës dhe u evidentua se, produktet ushqimore dhe të mishit, ishin sipas menisë ditore.

Kampionët e ushqimeve ruheshin në kushte frigoriferike dhe të etiketuara sipas vakteve përkatëse. Gjithashtu u konstatuan edhe racionet përkatëse për të sëmurët diabetikë në këtë institucion. Në përgjithësi, kushtet e përgatitjes së ushqimit në ambientet e kuzhinës të institucionit, rezultuan në gjendje të mirë.

Por, krahas kësaj situatë, grupi i inspektimit evidentoi faktin se, shpërndarja e ushqimit nga kuzhina në secilin sektorë bëhej me krahe nga stafi i të paraburgosurve të punësuar, pasi godinat nuk kishin ashensor dhe mungonin gjithashtu edhe karrocet për ndarjen e ushqimit. Gjatë shërbimit të vaktit të drekës nga njëra dhomë në tjetrën, u konstatua se enët e kuzhinës vendoseshin në tokë, për shkak pikërisht të mungesës të karrocave. Nga intervistat, të paraburgosurit shfaqën shumë ankesa lidhur me cilësinë e ushqimit, i cili **nuk** kishte larmishmëri. U evidentua se një pjesë e të paraburgosurve/dënuarve **nuk** e konsumonin ushqimin e përgatitur në institucion. Një numër i konsedurueshëm të paraburgosur, deklaroi se e merrnin ushqimin nga të afërmit e tyre dhe se nuk konsumonin ushqimin e institucionit, për shkak se nuk e pëlqenin atë.

Ky shqetësim, është konstatuar në vite edhe prej Avokatit të Popullit dhe për të arsye është rekomanduar Ministrit të Drejtësisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, ndryshimi i kuotës ushqimore të nevojshme për të burgosurit.

Në IEVP “Jordan Misja”, **nuk** kishte një njësi tregtare për ofrimin e produkteve të ndryshme për të paraburgosurit dhe të dënuarit. Mungesa e njësisë tregtare, u ngrit si shqetësim nga të paraburgosurit kryesisht shtetasit e huaj dhe prej atyre që kanë familjet larg, të cilët nuk kanë mundësi për tu dërguar ushqime dhe materiale të nevojshme për

nevojat personale. Nga drejtuesit e institucionit, u informuam se ky shqetësim është ngritur edhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, por sipas tyre nuk ka patur kërkesa nga subjektet private për ta hapur si njësi tregtare.

Gjithashtu, institucioni kishte nga 1(një) lavanderi për secilën godinë, të plotësuar me lavatriçe. Nga inspektimi rezultoi se, lavatriçet nuk punonin prej një periudhe 2 mujore. Përsa i përket larjes së çarçafëve dhe teshave personale, ato laheshin nga familjarët në pjesën më të madhe të rasteve ose nga vetë të dënuarit brenda ambienteve të tyre.

Regjimi dhe aktivitetet

Nga inspektimi i kryer në IEVP 313 “Jordan Misja”, rregjimi ishte i organizuar sipas orarit ditor të miratuar nga drejtori i institucionit. Orari i veprimtarive ishte i afishuar në zonën e kolonës të çdo sektori dhe në koridoret që dilnin në bokset e ajrimit. Veprimtaritë e parashikuara sipas programeve të miratuara për çdo sektorë ishin të njëjta, pavarësisht nga siguria që ata kishin.

Përsa i takon aktiviteteve të zhvilluara, ato ishin të reduktuara vetëm në ndjekjen e programeve të televizorit dhe lojërat e tavolinës (siç janë lojëra me letra dhe domino). Kjo, për shkak të masave kufizuese të vendosura për parandalimin e COVID-19, ashtu dhe për vetë kushtet e kufizuara që ofron infrastruktura e institucionit.

Këshillimet individuale dhe në grupe të të paraburgosurve, ishin të planifikuara në programet e tyre ditore nga specialistët e çështjeve shoqërore, por grupi i inspektimit konstatoi se ato nuk ishin efektive, pasi mungonin ambientet e punës të specialstëve në çdo sektorë, si dhe faktit se aktivitetet duhet të jenë të adresuara për ata individë dhe grupe të paraburgosurish, që realisht kishin nevojë për trajtime psiko-sociale të veçanta. Sipas informacionit të stafit të institucionit, të paraburgosurit dhe të dënuarit regjistroheshin në disa aktivitete, por jo gjithmonë i frekuentonin ato, ndaj dhe shkalla e informacionit ishte e limituar.

Nga shqyrtimi i dosjeve psiko-sociale dhe dokumentacioneve të tjera të mbajtura nga ky sektor, u vu re se ato formalisht ishin të plotësuar relativisht mirë me shënime periodike mbi takimet dhe aktivitetet ku të paraburgosurit merrnin pjesë. Në dosjet përkatëse ishin përfshirë si programet individuale të trajtimit ashtu dhe vlerësimet periodike.

Në lidhje me ajrimin u konstatua se ajrimi ditor zgjaste mbi 2 (dy) orë sipas rregullores dhe ky orar ishte edhe më i gjatë në periudhën e verës. Shumë prej të intervistuarve nëpër dhoma të pyetur për aktivitetet apo programet që ata marrin pjesë, kërkuan që për shkak të lirimit të masave kufizuese për pandeminë, të kenë më shumë aktivitete të përbashkëta edukative ose sportive.

Është për tu theksuar se një ndër qëllimet e institucioneve të mbyllura penitenciare është riintegrimi në shoqëri i personave, në momentin kur do të lënë burgun. Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon se “*regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin*

një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”⁷.

E drejta për të mbajtur kontakte me familjarët e tyre zbatohet sipas rregullores. Takimet me familjarët realizoheshin vetëm online 4 herë në muaj, në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Në ambientin e takimeve, ishin instaluar 2 poste me kompjutera për lidhje me skype me familjarët e tyre. Takimi online zgjaste jo më shumë se 15 minuta, për shkak dhe fluksit të lartë të takimeve që realizoheshin çdo ditë, duke e bërë këtë masë të pamjaftueshme.

Sikurse përmendëm dhe më lart, të paraburgosurit kërkonin të takonin fizikisht fëmijët dhe familjarët e tyre, për shkak dhe të lirimit të masave kufizuese, por nga informacioni dhe bërja publike e udhërit të Ministrisë së Drejtësisë, aktualisht ka filluar lejimi i një takimi fizik në muaj me familjen (3 takimet e tjera do vijojnë online), kundrejt ruajtjes së disa masave parandaluese të përhapjes së pandemisë në burgje, si vërtetimi nga familjarët për kryerjen e vaksinimit apo bërjen e tamponit me test negativ. Kjo është një masë tjetër shtërguese e domosdoshme, për të ruajtur parametrat shëndetësor të të burgosurve, por është dhe me kosto nga pikpamja ekonomike që do rëndoje buxhetet e këtyre familjeve.

Ndërsa, kontaktet me telefon kryeshin rregullisht, me 2 telefonata në javë/8 në muaj. Aparatet e telefonave ishin të vendosur në koridorin e çdo sektori. Nga intervistat e zhvilluara me të paraburgosurit, ata ngrinin shqetësimin e rritjes fiktive të çmimit të kartave telefonike dhe uljen e minutazhit nga 120 min në 70 min të bisedave. Sipas tyre, kjo ka ardhur si rezultat i mungesës të konkurrencës, pasi aktualisht funksionon vetëm një kompani telefonike, nga dy kompani që kanë patur kontrata për ofrimin e këtij shërbimi, në sistemin e burgjeve. Gjithashtu, ata kërkonin që në korridoret e secilit sektor, të afishoheshin numrat e telefonit për të kontaktuar me Institucionin e Avokatit të Popullit, pa tarifa shtesë dhe në çdo kohë.

Aktivitetet që zhvilloheshin, konsistonin në organizimin e festave me rastin e datave të rëndësishme festive ose fetare. Në ambientin e kultit nuk lejoheshin të mblidheshin praktikuesit e fesë muslimane dhe besimtarët protestantë, me qëllim që ata të praktikonin ritet e tyre fetare, për shkak të masave kufizuese. Por, për muajin e ramazanit, institucioni kishte hartuar një program të veçantë me aktivitete për besimtarët myslyman, si dhe kishte kryer gatime në kuzhinën e institucionit, sipas rriteve të tyre.

Biblotekat e institucionit gjendeshin në çdo zyrë këshillimi dhe në momentin e inspektimit ato nuk ishin të pajisur me libra të rinj. Librat ishin pjesë e inventarit të bibliotekës të cilët vireshin në dispozicion të të paraburgosurve apo të dënuarve për lexim sipas kërkesave. Aktualisht kishte 8(tetë) klasa që përdorshin si klasa edukimi në të dy godinat, ku ndodheshin raftet me libra të ndryshëm. Bibloteka, kishte një numër të konsiderueshme

⁷Rregullorja e Evropiane e Burgjeve Pika 25.1 dhe 25.2; <http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>

librash, por që nuk i përmbushin të gjitha kërkesat që kishin të paraburgosurit. Të paraburgosurit e regjistruar në bibliotekë, kishin nga një kartelë personale dhe nëpërmjet saj tërhiqnin dhe dorëzonin librat sipas kërkesave, megjithëse numri i të regjistruarve ishte shumë i kufizuar.

Në takimin që Avokati i Popullit zhvilloi me Drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve në muajin Maj 2021, u informuam se IEVP 313 “Jordan Misja”, ka patur një furnizim me libra të rinj për të paraburgosurit e këtij institucioni, në veçanti për të paraburgosurit që janë vendosur në regjimin e posaçëm të sigurisë së lartë.

Shërbimi Shëndetësor

Gjatë vizitës inspektuese në IEVP “Jordan Misja” Tiranë, si dhe në intervistat me të paraburgosurit në lidhje me ofrimin e shërbimit shëndetësor në institucion, u konstatuan disa problematika që kishin të bënin kryesisht me mungesën e medikamenteve mjeksore, të cilat shpesh mbulohehin nga kontributet e familjeve të paraburgosurve. Por, nga informacioni i personelit mjeksor të institucionit, rezultoi se skema e furnizimit dhe rimbursimit të ilaçeve funksiononte sipas kontratës tre paleshe mes institucionit, FSDKSH dhe depon farmaceutike. Mangësitë e konstatuara, vinin për shkak të mënyrës që funksionon sistemi, si edhe për shkak të dinamikës të lëvizjeve të të paraburgosurve e vonesave në plotësimin e dokumentacionit të dosjeve personale të tyre. Kjo situatë krijonte më tej problematika dhe vështirësi në pajisjen me librezë shëndetësore dhe për rrjedhojë edhe mungesa në sigurimin e ilaçeve, sipas nevojave që kishin të paraburgosurit.

Një problematikë që u evidentua në funksionimin e kësaj skeme, kishte të bënte dhe me emërtimin e ilaçeve që kurohej i paraburgosuri para se të hynte në institucion dhe emërtimin e ilaçeve të miratuara në listën e ribursimit për të njëjtën sëmundje. Në këto kushte, të paraburgosurit që vuanin nga sëmundje kronike nuk pranonin ilaçet e siguruar nga lista e ribursimit, por pranonin të kuroheshin me ilaçet e siguruar nga familjarët e tyre.

Përveç skemës trepalëshe me FSDKSH dhe depon farmaceutike, sigurimi me ilaçe në institucion, kryhej edhe nga dy burime të tjera, nëpërmjet furnizimit nga fondi i ilaçeve të siguruar nga DPB dhe blerjeve nga fondi i vetë institucionit, për të sëmurët kronikë apo dhe për të sëmurët me probleme akute.

Personeli i kujdesit mjekësor në I.E.V.P, “Jordan Misja”, Tiranë sipas organikës përbëhej nga 1(një) mjek, 1(një) farmacist, 1(një) stomatolog dhe 5 (pesë) infermierë. Mjeku aktual punonte me kohë të plotë në këtë institucion. Sikurse e theksuam edhe më lart, referuar organikës, mungesat konsistonin në 1 farmacist dhe 1 infermierë. Nga pikapamja e organizimit të punës të sektorit shëndetësor, nuk ndihej mungesa e stafit, për arsye edhe të transferimit të disa punonjësve dhe stafit nga IEVP “ Vaqarr” pranë këtij institucioni. Stafit ishte i plotë dhe nuk kishte asnjë mungesë.

Në të njëjtën kohë, u ngrit si ankesë nga të paraburgosurit, se nisur nga fakti që mjeku është i pranishëm në këtë institucion vetëm gjatë ditës dhe më pas, vetëm në kushte të domosdoshmërisë thirret ndihma urgjente mjekësore, shkakton në mënyrë të drejtpërdrejtë shkeljen e së drejtës për qasje deri te mjeku nga ana e personave të dënuar apo të paraburgosur, gjë që interpretuar dhe në qëndrimet e KPT⁸ parashikon që: *“Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet tu mundësohet qasja deri te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre” dhe se “shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme”.*

Në IEVP “Jordan Misja” Tiranë në katin e parë të tij të godinës kryesore ndodhej dhoma e stomatologut, dhoma e vizitave të mjekut, si dhe farmacia për institucionin. Dhoma e stomatologut ishte e pajisur me karrige dhe sterilizues, uniti dentar funksiononte dhe mjeku stomatolog ishte i pranishëm, sipas kërkesave të të paraburgosurve. Dhoma e mjekut në secilën nga godinat dhe farmacia ishin të lyera dhe ishin në gjendje të mirë me kushte të mira higjieno-sanitare. Institucioni ishte i pajisur me ambulancë të re për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit, sipas rekomandimit të mjekut të institucionit.

Në intervistat e zhvilluara me të paraburgosurit, u paraqitën ankesa që gjatë periudhës së pandemisë, ka patur vonesa në kryerjen e vizitave mjekësore te mjekët specialist të spitaleve, për shkak të kufizimit të lëvizjeve. Në vlerësimin e institucionit tonë, kjo përbën mohim të të drejtës për të marrë shërbim mjekësor të specializuar të të burgosurve që paraqesin shqetësime shëndetësore, kur kjo është e vlerësuar edhe nga mjeku i institucionit. Në këtë kuadër është për tu theksuar Rregullorja Evropiane e Burgjeve ku thuhet shprehimisht se: *“Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet”⁹.*

Në momentin e inspektimit në këtë institucion, sipas informacionit të sektorit të shëndetësisë, ishin 113 të burgosur me sëmundje kronike që trajtoheshin sipas rekomandimeve të mjekut, nga të cilët 46 persona me probleme të shëndetit mendor, 11 persona si përdorues droge (që marrin trajtim me metadon), 29 persona diabetikë, etj.

Gjithashtu, po sipas këtij informacioni, vetëm gjatë muajit Prill 2021 ishin kryer 206 vizita mjekësore te mjekët specialistë pranë QSUT-së Tiranë, me rekomandimin e mjekut të institucionit.

⁸ Komiteti për Parandalimin e Torturës

⁹ Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5;

Personeli i infermierëve që jepnin terapinë e të sëmurëve kronikë dhe atyre akutë, ndiqnin procedurën duke qënë prezent në momentin e marrjes së terapisë dhe mos lënien e medikamenteve në dhomat e tyre.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, e në veçanti atij të mjekut, u konstatua se kartelat klinike mbaheshin në dollap në dhomën e mjekut. Gjithashtu u këqyren regjistri i vizitave të mjekut, regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve, të cilat ishin mbajtur me rregull.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku parashikohet midis të tjerash se: “Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues”:

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme, për rikonstrukcionin e plotë të godinës “A” në I EVP “Jordan Misja” Tiranë, duke krijuar mjedise të përshtatëshme banimi dhe respektuar për të paraburgosurit normën minimale të hapësirës dhe sipërfaqes të nevojshme për person, 6m² për dhomat me një person dhe 4m² për person në dhomat ku ndodhen më shumë se dy persona.
2. Të merren masa të menjëhershme për rishikimin e akteve të brendshme që përcaktojnë kapacitetet akomoduese të I EVP-së 313 “Jordan Misja”, në përputhje me aktet ligjore në fuqi, nisur nga e drejta për normat minimale të hapsirës dhe sipërfaqes për çdo të burgosur, me qëllim që personat që akomodohen në dhomat e banimit të këtij institucioni, t’u garantohet trajtimi njerëzor dhe njëkohësisht sa më dinjitoz i tyre.
3. Të merren masa të menjëherëshme në sektorin e tranzitit, observimit dhe të veçimit, që ato të kompletohen me materiale të reja për fjetje si dyshekë, jastek dhe batanie, pajisje të kuzhinës si pjata, gota dhe lugë, si dhe për lyerjen dhe dizifektimin e këtyre dhomave të banimit, pasi në kushtet që janë përbejnë një risk të shtuar me pasoja të rënda për shëndetin e personave që ndodhen në këto ambiente.
4. Marrjen e masave të menjëhershme në sektorin e tranzitit, observimit dhe të veçimit, për të kompletuar tualetet që ndodhen brenda në dhoma e tyre, me pajisjet e nevojshme hidrosanitare dhe të mbyllen me dyer të rregullta.

5. Marrjen e masave të menjëherëshme, për kompletimin me karroca që shërbejnë për shpërndarjen e ushqimit për secilin sektorë më vete, duke garantuar cilësinë e gatimit të ushqimit dhe atë të shpërndarjes në dhomat e banimit, sipas standardeve për një trajtim njerëzor dhe dinjitoz të këtyre personave.
6. Të merren masa të menjëherëshme, për riparimin e rrjetit elektrik dhe sigurimin e kushteve të përshtatëshme për ngrohje të dhomave të të paraburgosurve në godinën “A” të këtij institucioni, sipas kushteve klimaterike.
7. Marrjen e masave të menjëherëshme, për shtimin e aktiviteteve dhe takimeve me të paraburgosurit për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi, si edhe aktiviteteve edukative e social-kulturore-sportive.
8. Marrjen e masave të nevojshme, për vënien në funksionim dhe plotësimin e ambienteve të palestrave me bazën materiale të nevojshme, me qëllim shfrytëzimin e tyre nga të paraburgosurit, brenda orarit dhe grafikut të miratuar nga drejtuesit e institucionit.
9. Të merren masa për shtimin e të paktën një kompjuteri në ambientin ku zhvillohen takimet online, si dhe të shtohet për të paraburgosurit minutazhi i takimeve online me familjarët e tyre.
10. Marrja e masave të menjëherëshme, në kuadër të masave për parandalimin e sëmundjes infektive COVID-19, për furnizimin me detergjentë shtesë të paraburgosurve, për mbajtjen e higjenes dhe pastërtisë vetjake, si dhe mjediseve të banimit e ambienteve të përbashkëta.
11. Marrjen e masave të nevojshme, për hapjen e veprimtarisë së njësisë tregtare në këtë institucion, për ofrimin e produkteve të ndryshme sipas kërkesave të të paraburgosurve.
12. Marrjen e masave të menjëherëshme, për afishimin në vende të aksesueshme për të paraburgosurit, numrat e kontaktit të telefonave të Institucionit të Avokatit të Popullit.
13. Marrjen e masave të nevojshme për plotësimin e organikës të institucionit me staf, kryesisht të 1 përgjegjës i sektorit të logjistikës, 1 specialist në sektorin e shërbimit ligjor, 1 farmacist, 1 ndihmësmjek, etj.
14. Marrjen e masave të menjëherëshme, për riparimin e lavatriçeve dhe vënien në funksionim të lavanderisë për larjen e teshave dhe çarçafëve të të paraburgosurve.
15. Marrjen e masave të menjëherëshme, për kompletimin me libra të rinj të bibliotekave që ndodhen në regjimin e brendshëm, kryesisht asaj që ndodhet në regjimin e posaçëm të sigurisë së lartë, si dhe nxitjen e të paraburgosurve për interesimin ndaj leximit të librave.
16. Marrjen e masave për krijimin e kushteve në seksionin e posaçëm të regjimit të sigurisë së lartë në IEVP “Jordan Misja” Tiranë, *(i ashtuquajtur 41-bis)* në kuadër të miratimit

të paketës ligjore për sistemin penitenciar, në përputhje me nenin 17 i ligjit 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, si dhe rekomandimit të Avokatit të Popullit¹⁰, me fokus garantimin e të drejtave dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve në regjimin e posaçëm, në mënyrë që të burgosurit që do të akomodohen në këto ambiente të mos privohen nga aktivitetet sportive, kulturore, krijuese, shërbimi bibliotekar, veprimtari që i shërbejnë edhe rehabilitimit/ riintegritit të të burgosurit, si dhe mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së tyre, duke ruajtur një ekuilibër midis sigurisë dhe dinjitetit të të paraburgosurve.

17. Marrjen e masave të nevojshme, për bashkëpunimin me institucionin e Ministrisë së Drejtësisë në nxitjen e procesit për ndryshimin e Urdhërit të përbashkët nr.104/5 prot., datë 19.06.2006 të Ministrit të Drejtësisë dhe nr.205/5 prot., datë 27.07.2006 të Ministrit të Shëndetësisë, “Për miratimin e normave të ushqimit ditor për të dënuarit”, me qëllim përmirësimin e larmisë së menysë të ushqimit të të burgosurve.

18. Marrjen e masave të nevojshme, për bashkëpunimin me institucionin e Ministrisë së Drejtësisë në nxitjen e procesit të hartimit të akteve nënligjore, të parashikuara në ligjin 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, përkatësisht në neni 43 nenin 44 për rregullat e posaçme për punësimin e të burgosurve dhe kriteret për shpërblimin për secilën kategori.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

Ermonela XHAFA

¹⁰ Rekomandim nr.K4/A4-5 prot., datë 23.09.2020 drejtuar Ministrit të Drejtësisë dhe DPB.